



# Zhvillimi I (Pa) Qëndrueshëm i Turizmit në Shqipëri

**RAPORT** MONITORIMI

Maj - Korrik 2023

QENDRESA  
QYTETARE



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)



AUTOR  
**TEISA KURTI**

## Tabela e përmbajtjes:

<b>Tabela e përmbajtjes:</b>	2
<b>Hyrje</b>	3
<b>Situata aktuale dhe Strategjia Kombëtare Turizmit</b>	3
<b>Turizmi i qëndrueshëm dhe zhvillimi i tij në vendin tonë</b>	5
<b>Sfidat e turizmit në Shqipëri dhe nevoja për një zhvillim të qëndrueshëm</b>	7
<i>Produkti turistik</i>	7
<i>Infrastruktura dhe strukturat akomoduese</i>	8
<i>Burimet njerëzore</i>	10
<i>Teknologjia e informacionit</i>	10
<i>Ndotja dhe mjedisi</i>	11
<b>Gjetjet kryesore</b>	12
<b>Rekomandime</b>	13
<b>Bibliografia</b>	15

## Hyrje

Turizmi në Shqipëri ka përjetuar një rritje të ndjeshme gjatë viteve të fundit, kjo si rezultat i bukurive natyrore të vendit, pasurisë së trashëgimisë kulturore dhe historike, si dhe përpjekjeve të ndërmarra për të promovuar dhe trumpetuar industrinë turistike.

Referuar statistikave nga burime zyrtare, Shqipëria së fundi është shndërruar në një destinacion tërheqës në Evropë e më gjerë për turistët e huaj.

Statistikat janë optimiste përse i takon numrit të turistëve që kanë zgjedhur Shqipërinë, megjithatë, është e rëndësishme të përmendet se zhvillimi i turizmit duhet të shoqërohet me përkujdesje për mbrojtjen e mjedisit dhe të trashëgimisë kulturore, si dhe për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve turistike. Turizmi i qëndrueshëm ka potencialin për t'u bërë shtytësi kryesor si kundërpeshimi i qasjes turistike masive sezonale që rrit kërkesën dhe ofertën dhe ofron zgjidhje aktuale/të ardhshme për turizmin. Ky raport ka për qëllim monitorimin e situatës aktuale të zhvillimit të turizmit në Shqipëri jo përse i përket shifrave, por referuar politikave dhe strategjive të ndërmarra nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Gjithashtu ky punim synon të ofrojë një pasqyrë të plotë dhe të detajuar të sektorit turistik në Shqipëri, duke shpalosur rëndësinë e diversifikimit të produkteve turistike me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të tij. Për këtë qëllim, punimi trajton sfidat dhe mundësitë në këtë sektor si dhe propozimin e rekomandimeve që mund të ndihmojnë në përmirësimin e infrastrukturës, shërbimeve dhe strategjive të zhvillimit për secilën prej tyre.

## Situata aktuale dhe Strategjia Kombëtare Turizmit

Turizmi është kthyer në një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare, duke u konsideruar në këtë mënyrë, si një ndër motorët kryesorë të zhvillimit dhe rritjes ekonomike të vendit.

Gjatë dy dekadave të fundit, kontributi i turizmit dhe sektorit të udhëtimeve në Produktin e Brendshëm Bruto (PBB) të vendit është rritur dhe ka arritur në më shumë se 8%, duke krijuar vende pune dhe duke gjeneruar 38% të totalit të eksporteve. Duke hedhur vështrimin mbrapa, 2019-a ishte viti më i mirë i Shqipërisë për turizmin me 6.4 milionë vizitorë të huaj dhe 2.3 miliardë dollarë të ardhura të gjeneruara, referuar edhe numrit të lartë të punonjësve në këtë sektor.<sup>1</sup> Sipas Këshillit Botëror të Turizmit dhe Udhëtimit vlerësohet se një në pesë vende pune në Shqipëri është e lidhur me turizmin, udhëtimin dhe aktivitetet e lidhura

<sup>1</sup> <https://www.unwto.org/tourism-statistics/key-tourism-statistics>

<https://www.instat.gov.al/media/11207/tab-1.xlsx>

me to.<sup>2</sup> Shifra këto më të larta se vitet që pasuan, kjo si pasojë e pandemisë Covid-19.

Aktualisht, sipas deklaratave zyrtare të Ministrisë së Truizmit dhe Mjedisit, por edhe të dhënave nga INSTAT, gjatë gjashtëmujorit të 2023, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është rritur me 33,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022 dhe vetëm për muajin Korrik, 1.7 milionë vizitorë të huaj kanë zgjedhur të vizitojnë Shqipërinë, 26% më shumë krahasuar me një vit më parë.<sup>3</sup> Duket se tashmë sfida e vetme e institucioneve publike është ajo me shifrat, duke nisur kështu një luftë me të dhenat statistikore të viteve post-pandimke, ku në thelb këto shifra nuk përmbajnë një analizë të detajuar jo vetëm sasiore, por që përmban tregues të ndikimit që kanë sjellë në këtë sektor.

Parë nga ky këndvështrim, vërehet se nevoja për një sistemi të integruar të statistikave është kthyer në një sfidë për Shqipërinë. Kjo si pasojë se nuk ka një ndërlidhje të të dhënave ndërmjet ministrive, për ta bërë impaktin më të matshëm, pra jo vetëm në tregues sasior. Në fakt ky problem është evidentuar edhe në Forumin për Mjedisin dhe Turizmin e Qëndrueshëm (FESTA) në bashkëpunim me World Tourism Organization (UNËTO).<sup>4</sup>

Nga ana tjetër, referuar kuadrit ligjor në vendin tonë, përveç ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, Këshilli i Ministrave ka vendosur me Vendimin nr. 413, datë 19.6.2019 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019–2023 dhe të planit të veprimit"<sup>5</sup>, me qëllim:

- I. Krijimin e poleve dhe industrive të reja të zhvillimit, si dhe konsolidimi i ofertës turistike;
- II. Rritja e vlerës së shtuar dhe e impaktit të sektorit në ekonomi dhe punësim
- III. Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të reja në turizëm, si dhe përmirësimi i cilësisë së tyre.
- IV. Përmirësimi i imazhit të vendit dhe promovimi i produkteve lokale.

Një strategji në dukje serioze dhe e mirëmenduar, ku përcaktohet buxheti, strukturat përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin, ku ky i fundit do të ndiqet nga Grupi Tematik për Zhvillimin e Turizmit dhe

<sup>2</sup> <https://wtfc.org/research/economic-impact>

<sup>3</sup> <https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%3ABrbimet/turizmi/publikimet/2023/strukturat-akomoduese-qershor-2023/>

<sup>4</sup> Tourism Data and Matching Priorities - Albania <https://www.unwto.org/europe/albania>

<sup>5</sup> Vendimin nr. 413, datë 19.6.2019 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019–2023 dhe të planit të veprimit" [https://qbz.gov.al/share/oz0UGis3QXmP\\_HEzZ8Rng](https://qbz.gov.al/share/oz0UGis3QXmP_HEzZ8Rng)

Kulturës dhe Prefektët e Qarqeve, kryesuar nga Zëvendësministri pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si dhe mënyra e raportimit.

Për nevoja të raportimit grupi takohet së paku dy herë në vit, ndërsa objektivi kryesor i punës së tij është diskutimi dhe aprovimi i planit vjetor të veprimit, raportit vjetor për zbatimin dhe monitorimi i realizimit të aktiviteteve.

Duket se çdo gjë është e përcaktuar, por ajo çfarë mungon është pikërisht transparenca mbi këto raporte monitorimi të haturara nga grupet e punës apo edhe vetë plani vjetor, duke e bërë të pamundur vlerësimin e performacës dhe ndikimit që kjo strategji solli. Theksojmë se edhe pse të gjendur në katër mujorin e fundit të kësaj strategjie, përveç se nuk kemi rezultate të matshme, duket se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka shprehur planin e ardhshëm për një strategji të re dhe as nuk ka nisur konsultimet për këtë.

## Turizmi i qëndrueshëm dhe zhvillimi i tij në vendin tonë


Turizmi i qëndrueshëm është një mënyrë e zhvillimit të turizmit që synon të respektojë dhe të ruajë burimet natyrore, kulturën dhe identitetin e një destinacioni, ndërsa kontribuon në mirëqenien ekonomike dhe sociale të komuniteteve vendase. Ky lloj turizmi fokusohet në tërheqjen e turistëve në mënyrë që të ndikojë minimalisht në mjedisin dhe kulturën lokale dhe të jetë një mekanizëm për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave turistike.

Në këtë kuptim, synohet të balancohet ndërtimi i infrastrukturave turistike me respektimin e natyrës dhe mjedisit, të promovohet transporti publik ekologjik, të inkurajohet përdorimi i burimeve të rinovueshme energjitike, të mbrohet biodiversiteti dhe ekosistemet lokale, dhe të përfshihen komunitetet vendase në vendimmarrjen dhe të përfitojnë nga arritjet e industrisë së turizmit.

Turizmi i Qëndrueshëm nuk lidhet me një lloj të veçantë të turizmit, por është një aspiratë që ndikimet e të gjitha formave të turizmit të jenë të qëndrueshme për brezat e ardhshëm.

Për shembull, disa praktika të turizmit të qëndrueshëm përfshijnë:

- Zhvillimi i infrastrukturave të përshtatshme dhe të një masë të përbalueshme nga mjedisi.
- Edukimi i turistëve për respektimin e kulturës dhe zakoneve të komuniteteve vendase.



- Promovimi i gastronomisë dhe produkteve artizanale lokal.
- Mbështetja e iniciativave të energjisë së rinovueshme dhe reduktimit të ndotjes.
- Përkrahja e projektave të mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit.
- Kufizimi i numrit të turistëve në zona të ndjeshme natyrore.
- Qëllimi kryesor i turizmit të qëndrueshëm është të sigurojë që përfitimet nga turizmi të ndahen në mënyrë të drejtë dhe të qëndrueshme për komunitetet vendase, ndërsa shfrytëzohet dhe ruhet potenciali turistik për brezat e ardhshëm.

Vendi ynë nga ana tjetër në përpjekje për të promovuar kudo madje dhe në mediat ndërkombëtare, destinacionet turistike si dhe bukuritë natyrore me qëllimin për të shtuar numërin e turistëve, gabojmë rëndë duke mos menduar pasojat që ky promovim sjell. Tashmë Shqipëria është kthyer në një atraksion me çmime "low cost" dhe me bukuri natyrore si shume vende të tjera të botës, të cilat hera herës janë të papërbalushme nga të gjithë, dhe për rrjedhojë Shqipëria është bërë opsioni më i mirë i mundshëm. Duke e kthyer turizmin në masiv dhe aspak të qëndrueshëm, i cili sjellë shumë pasoja për një vend të vogël dhe jo shumë të zhvilluar.

Ky problem tashmë është ndërkombëtar dhe shtete të ndryshme kanë ndërmarrë një sërë masash apo strategjish lidhur me turizmin masiv të cilat gjenden të ilustruara më poshtë.

Barcelona, Spanjë: Në Barcelonë, aktiviteti turistik është shumë i pabarabartë në të gjithë territorin me një nivel të lartë mbipopullimi (overtourism) në zona të caktuara përreth atraksioneve kryesore si rrethinat e Sagrada Familia, Parku Güell ose pjesa më e madhe e Ciutat Vella (Qytet i vjetër). Për rrjedhojë nga institucionet publike në Barcelonë janë ndërmarrë hapa për të menaxhuar turizmin e tepërt dhe për të promovuar praktikën e qëndrueshme. Qyteti ka zbatuar masa si kontrolli i numrit të anijeve kryesore dhe menaxhimi i numrit të vizitorëve të atraksioneve të famshme.<sup>6</sup>

Dubrovnik, Kroaci: Ky rast shërben si një rast studimor bindës në turizmin e qëndrueshëm. Duke u përballur me sfidat e mbipopullimit (overtourism) për shkak të sharmit të tij historik dhe popullaritetit nga "Game of Thrones", qyteti zbatoi masa për të balancuar ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore me kërkesat e turizmit. Menaxhimi i vizitorëve, përmirësimet e infrastrukturës, përfshirja e komunitetit,

<sup>6</sup>Albert A., Claudio M., 'Overtourism'? *Understanding and Managing Urban Tourism Growth beyond Perceptions Volume 2: Case Studies*, pg. 21  
[https://www.researchgate.net/publication/331582932\\_Case\\_study\\_3\\_Barcelona\\_Spain](https://www.researchgate.net/publication/331582932_Case_study_3_Barcelona_Spain)

promovimi i turizmit jashtë pikut, mbrojtja kulturore dhe mjedisore, transporti i qëndrueshëm, mbështetja për ekonominë lokale, iniciativat e gjelbra dhe edukimi janë komponentët kryesorë të përpjekjeve të turizmit të qëndrueshëm të Dubrovnikut.<sup>7</sup>

## Sfidat e turizmit në Shqipëri dhe nevoja për një zhvillim të qëndrueshëm

### **Produkti turistik**

Shqipëria po rekomandohet gjithnjë e më shumë si një destinacion turistik nga mediat prestigjioze ndërkombëtare përmes artikujve e reportazheve, duke e sugjeruar Shqipërinë si një mundësi që nuk duhet humbur në Evropë.

Mirëpo edhe nga këto reportazhe vërehet se industria e turizmit është e përqendruar vetëm tek bregdeti, ndërkohë që kryesisht turizmi malor dhe qindra atraksione turistike të vendit, së bashku me atraksionet e trashëgimisë sonë kulturore e historike janë braktisur dhe harruar deri në degradimin e tyre. Fatkeqësisht, nënsektori i “turizmit blu” të Shqipërisë, duke përfshirë shëtitjen me varkë, zhytjen, peshkimin dhe sportet ujore, mbetet kryesisht i pazhvilluar. Për më tepër, pavarësisht trashëgimisë kulturore unike të Shqipërisë, turizmi kulturor përfaqëson një pjesë të vogël të industrisë.

Referuar Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023, produktet turistik klasifikohen vetëm në tre kategori të cilat përfshijnë turizmin bregdetar, turizmin natyror dhe turizmin tematik. Një klasifikimi i mbyllur dhe jo strategjik për zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori.

Krijimi i një identiteti të produkteve turistike do të luftonte turizmin sezonal dhe sasior, duke bërë të mundur që Shqipëria të vizitohet në cdo sezon nga turistët dhe të mund të tërheqë turizëm cilësor. Për këtë lind nevoja e zhvillimit të produkteve turistike të qëndrueshme me ndikimi pozitiv i cili përfshin krijimin e vendeve të punës, ruajtjen dhe interpretimin e trashëgimisë kulturore, mbrojtjen e florës dhe faunës, restaurimin e peisazhit etj.

Produktet turistike që ofrojnë zhvillim të qëndrueshëm janë ato që integrojnë parimet e qëndrueshmërisë mjedisore, shoqërore dhe ekonomike. Këto produkte përmirësojnë përvojën e udhëtarëve ndërkombëtarë duke përfshirë ndikimin pozitiv në vendin që ata vizitojnë dhe duke ndihmuar në mbrojtjen e burimeve natyrore dhe

<sup>7</sup>Ivica P., Malden K., Tina S 'Overtourism'? *Understanding and Managing Urban Tourism Growth beyond Perceptions Volume 2: Case Studies*, pg. 40  
[https://www.researchgate.net/publication/331582932\\_'Case\\_study\\_3\\_Barcelona\\_Spain'](https://www.researchgate.net/publication/331582932_'Case_study_3_Barcelona_Spain')

kulturale për brezat e ardhshëm. Disa shembuj të produkteve turistike të qëndrueshme janë:

- ▶ Turizmi Natyror apo Ekoturizmi: Këto produkte inkurajojnë vizitorët të eksplorojnë natyrën dhe ekosistemet e vendit në një mënyrë që nuk i dëmton ato. Aktivitete si ecje në natyrë, udhëtime me bicikletë, birdwatching etj., ndihmojnë në sensibilizimin ndaj mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit.
- ▶ Turizmi Kulturor dhe Trashëgimor: Këto produkte përfshijnë vizitat në vende historike, monumente, muzeume dhe ngjarje kulturore. Përmirësimi i ndërgjegjësimit ndaj trashëgimisë kulturore dhe mbrojtja e vlerave të kulturës tradicionale janë të rëndësishme për këto produkte.
- ▶ Agroturizmi dhe Gastronomi Lokale: Ky lloj turizmi inkurajon vizitorët të njihen me jetën rurale dhe bujqësore të vendit. Përmes vizitave në fermat vendore, gatimit të ushqimeve të traditës dhe degustimeve të produkteve të zonës, vizitorët ndihen pjesë e kulturës dhe ekonomisë vendore. Si shembull mund të merret rasti i Italisë, e cila ka zhvilluar turizmin rural dhe agroturizmin, duke u fokusuar në përvojat autentike të jetës së fshatit dhe bujqësisë. Kjo ka ndihmuar në shpërndarjen e turizmit në zona më të largëta dhe ka promovuar jetën rurale tradicionale.
- ▶ Turizmi i Aventurave dhe Aktiviteteve Sportive: Këto produkte inkurajojnë aktivitete të ndryshme aventurike si lundrimi në ujë të hapur, rafting, skive, dhe sporte të tjera natyrore. Përvojat e këtij lloji janë të pasura me emocion dhe aventurë, duke ndihmuar edhe në mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit. Shembull për këtë është Holanda, e cila është e famshme për kulturën e ecjes me biçikletë. Rrjeti i gjerë i rrugëve për biçikleta dhe infrastruktura miqësore ndaj biçikletave inkurajon transportin e qëndrueshëm. Amsterdam, si shembull, promovon ecjen me biçikletë mbi makinat dhe ka politika në vend për të reduktuar ndotjen e ajrit dhe ngjerrjen. Qyteti gjithashtu fokusohet në uljen e ndotjes dhe menaxhimin efikas të mbeturinave.

Si çdo sfidë tjetër edhe zhvillimi i produkteve turistike në vendin tonë lidhet ngushtë me sfidat të tjera kryesisht si infrastruktura.

### **Infrastruktura dhe strukturat akomoduese**

Infrastruktura është një tjetër problem që rrezikon tërheqjen e turizmit elitare, i cili kërkon kushte të veçanta për t'u zhvilluar, duke nisur nga rrugët e transportit, qoftë ai rrugor, ajror apo detar, deri tek strukturat akomoduese ku ata do të pushojnë.



Shumë zona turistike nuk kanë rrugë apo edhe ndricim, sidomos zonat malore apo edhe ato bregdetare, duke ndikuar negativisht në eksperiencën e turistëve apo edhe duke i vënë në rrezik ata, përmendim këtu rastet e humbjes së jetës apo shpëtimit të turistëve të humbur në zona malore.<sup>8</sup>

Për të përmirësuar këtë situatë, Shqipëria ka nevojë për investime të mëtejshme në infrastrukturë, planifikim të qëndrueshëm dhe bashkëpunim të ndërmjetëm publik-privat. Infrastruktura e përshtatshme do të ndihmonte në rritjen e turizmit, duke promovuar një përvojë të shkëlqyeshme për turistët dhe një turizëm të qëndrueshëm në tërë territorin e vendit.

Nga ana tjetër infrastruktura e strukturave akomoduese është një tjetër sfidë. Shumë nga strukturat akomoduese, por edhe ofrues të tjerë shërbimesh, si restorante apo udhërrëfyes turistikë, operojnë në informalitet të plotë duke krijuar terrenin për shërbime të një cilësie të ulët, duke ndikuar në sigurinë e turistëve dhe në imazhin e vendit.

Në zbatim të Urdhrit nr. 267, datë 24.07.2019 "Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese",<sup>9</sup> i ndryshuar, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka filluar procesin e Kategorizimit të Strukturave Akomoduese, por duket se ky proces nuk është finalizuar edhe pse kanë kaluar 4 vite nga miratimi i këtij akti.

Sipas të dhënave të INSTAT, gjatë muajit Qershor, norma e shfrytëzimit të dhomave të "Hoteleve dhe akomodimeve të ngjashme" është 28,5 %, kundrejt 22,9 % që ishte në muajin Qershor 2022. Norma e shfrytëzimit të shtretërve të "Hoteleve dhe akomodimeve të ngjashme" është 30,5 %, kundrejt 23,2 % që ishte në muajin Qershor 2022.<sup>10</sup> Duket se shifrat kanë pësuar një regres, por arsyeja e këtij regresi nuk është e qartë. Një arsye potenciale e këtij regresi në shifra i atribuohet edhe strukturave akomoduese informale.

<sup>8</sup> <https://euronews.al/kishin-humbur-ne-gjirin-e-grames-shpetohen-dy-turistet-gjermane-incidenti-megenin/>

<https://euronews.al/humb-jeten-turisti-serb-ne-valbone/>

<sup>9</sup>Urdhrit nr. 267, datë 24.07.2019 "Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese", <https://qz.gov.al/share/YeMgm9PgRBiuOAIgblwC3g>

<sup>10</sup> <https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/turizmi/publikimet/2023/strukturat-akomoduese-qershor-2023/>

## Burimet njerëzore

Burimet njerëzore kanë qenë një nga sfidat kryesore të sektorit të turizmit në Shqipëri.<sup>11</sup> Problematika e burimeve njerëzore lidhet me mungesën e trajnimit të specializuar, nivelin e ulët të njohurive gjuhësore, dhe të tjera.

Pjesa e madhe e punës në sektorin e turizmit është sezonal, dhe pagat janë të ulëta. Kjo vështirëson mbajtjen e punonjësve të kualifikuar dhe angazhimin e tyre të qëndrueshëm. Në disa raste të tjera, punonjësit në industrinë e turizmit nuk janë të aftë për t'ju përgjigjur efikasht ndaj kërkesave dhe nevojave të turistëve, duke ndikuar në përvojën e tyre.

Kualifikimi i pamjaftueshëm i punonjësve në fusha të ndryshme të turizmit, si udhërrëfyesit turistik, kuzhinierët, dhe personeli i shërbimit, mund të ndikojë në cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Shpesh herë sektori privat duket se çdo ditë e më shumë si zgjidhje për mungesën e fuqisë punëtore po preferon të punësojë staf të huaj.

Nevoja për formim të vazhdueshëm profesional për burimet njerëzore të industrisë së turizmit për të siguruar cilësinë e shërbimeve dhe përballjen me rritjen e numrit të turistëve mbetet ende një sfidë. Për të adresuar këto probleme, është e rëndësishme që qeveria dhe sektori privat të investojnë në trajnime, zhvillim profesional, rritje të pagave, dhe mbështetje të përgjithshme për punonjësit e turizmit. Kjo do të ndihmonte në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe në rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit të turizmit në Shqipëri.

## Teknologjia e informacionit

Përdorimi i teknologjive të informacionit në industrinë turistike është i kufizuar.<sup>12</sup> Me përjashtim të ndonjë rasti të rrallë, kryesisht me ndihmën e organizatave ndërkombëtare, ofrimi i shërbimeve digjitale për turistët është ende i pazhvilluar, fakt ky i pranuar në Strategjinë Kombëtare të Turizmit. Në të njëjtin nivel është edhe përdorimi i tyre, për marketingun e shërbimeve dhe produkteve edhe shitjen në tregje.

<sup>11</sup> <https://blogs.worldbank.org/europeandcentralasia/tourism-20-albania-new-opportunity-resilient-growth>

<sup>12</sup> Vendimin nr. 413, datë 19.6.2019 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019–2023 dhe të planit të veprimit" pg 11

[https://qz.gov.al/share/ozUGis3QXmP\\_HEzZ8Rng](https://qz.gov.al/share/ozUGis3QXmP_HEzZ8Rng)

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, përmes Agjencisë Kombëtare të Turizmit ka prezantuar në fund të muajit Qershor, aplikacionin TEA (Tourism Events of Albania), kalendarin digjital të turizmit, një platformë e mbi eventet turistike, kulturore, dhe artistike. Por ky aplikacion nuk i përmbush nevojat e turistëve që vizitojnë vendin tonë pasi ende nuk ka një platformë të unifikuar dhe bazë për transportin, i cili mund të lehtësojë përvojën e tyre.

## ***Ndotja dhe mjedisi***

Ndotja është ndër problemet kryesore, që kërkon vëmendje të madhe nëse duam të kemi turizm elitare. Këtu nuk i referohemi vetëm ndotjes nga mbetje të hedhura nga turistët, por një problem madhor mbetet, sidomos në bregdet, mbeturinat që sjellin lumenjtë, pasi siç dihet lumenjtë e vendit tonë janë vendgrumbullim mbetjesh, të ndikuar nga kontrolli i dobët i strukturave shtetërore, si dhe ndërgjegjja e ulët qytetare.

Të gjitha këto mbeturina përfundojnë në det, ashtu si dhe ujërat e zeza të qyteteve pranë bregdetare ndër të tjera duke rrezikuar dhe shëndetin publik. Shembulli për këtë mund të shihet në gjithë bregdetet pranë grykëderdhjeve të lumenjëve në Ulëtisrën Perëndimore kryesisht. Ndotja nga industria është një tjetër fenomen shqetësues, si për tokën, ajrin, ujin dhe peizazhin në përgjithësi. Kështu, shumë industri që janë anës lumenjëve derdhin mbetjet e tyre të lëngëta e të ngurta në lumenj, të cilat më pas përfundojnë në det.



## Gjetjet kryesore


- Në vitet e fundit, Shqipëria është kthyer në një destinacion tërheqës me turizëm sezonal dhe masiv, jo cilësor dhe aspak të qëndrueshëm. Nga kjo pikëpamje zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm mbetet ende një sfidë për vendin tonë.
- Turizmi në Shqipëri ka rritur kontributin në ekonominë vendase, duke krijuar vende pune dhe tërhequr investime. Megjithatë, ka sfida si mungesa e integritetit të të dhënave statistikore dhe koordinimit ndërmjet ministrive, e cila bën të pamundur përcaktimin real të ndikimit që ky sektor ka patur në vend.
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka përpiluar një strategji për zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, por nuk ka mundur të bëjë transparencë mbi implementimin e strategjisë.
- Turizmi i qëndrueshëm synon të respektojë mjedisin dhe kulturën lokale, të përfitojë komunitetin vendas, dhe të jetë i qëndrueshëm për brezat e ardhshëm. Zhvillimi i produkteve turistike të qëndrueshme është kyç për luftimin e turizmit sezonal dhe përforcimin e turizmit cilësor. Këto produkte përfshijnë turizmin natyror, kulturor, agriturizmin, dhe aventurën sportive. Si shembull mbi menaxhimin e turizmit masiv apo politikave të qëndrueshme janë shumë vende të Europës si Spanja, Koracia, Italia që kanë implementuar modelet e tyre. Turizmi i qëndrueshëm i referohet po ashtu turizmit të përhershëm dhe jo-sezonal, i cili po ashtu do të ishte i mundshëm vetëm nëpërmjet zhvillimit të produkteve turistike
- Sfidat për turizmin në Shqipëri përfshijnë mungesën e produkteve turistike të diversifikuara, infrastrukturën të papërshtatshme dhe kategorizimin e dobët të akomodimeve. Mungesa e burimeve njerëzore të kualifikuara, trajnimit të përshtatshëm, dhe pagave të ulëta ndikojnë në cilësinë e shërbimeve.
- Për sa i përket infrastrukturës dhe problemeve që shfaqen edhe pse kanë kaluar 4 vite nga miratimi i procedurave për Kategorizimin e Strukturave Akomoduese, duket se ky proces ende nuk është finalizuar.
- Edhe pse në përfundim të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019–2023, përveç se nuk kemi rezultate të matshme, duket se Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka shprehur asnjë plan të ardhshëm për një strategji të re dhe as nuk ka nisur konsultimet për këtë.
- Nga vlerësimi i të gjithë komponentëve, duket se zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm në Shqipëri është ende larg.

## Rekomandime

- Zhvillimi i Planifikimit të Qëndrueshëm: Qeveria Shqiptare, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe autoritetet vendore duhet të përqëndrohen në hartimin dhe zbatimin e planeve të qëndrueshme për zhvillimin e turizmit. Kjo përfshin identifikimin e zonave të rrezikuara për ndotjen dhe përherësimin e tyre, si dhe përcaktimin e numrit të turistëve që mund të priten në çdo zonë pa dëmtuar mjedisin dhe kulturën.
- Investime në Infrastrukturë: Qeveria dhe investitorët privat duhet të fokusohen në investime në infrastrukturë të përshtatshme, duke përmirësuar aksesin në zona tërheqëse turistike dhe ndërtuar infrastrukturë të qëndrueshme dhe të përputhshme me karakteristikat natyrore dhe kulturore të destinacioneve.
- Diversifikimi i Produkteve Turistike: Nëpërmjet politikave si dhe nëpërmjet bashkëpunimit me sektorin private duhet të investohet në zhvillimin e produkteve turistike të ndryshme, duke përfshirë turizmin natyror, kulturor, agrikulturor dhe atë sportiv. Kjo do të ndihmonte në zvogëlimin e përqendrimit të disa zona të caktuara dhe do të shpërndahte më mirë përfitimet ekonomike dhe impaktin në të gjithë vendin.
- Trajnimi dhe Kualifikimi i Burimeve Njerëzore: Qeveria dhe sektori privat duhet të investojnë në programe trajnimi dhe zhvillim profesional për punonjësit e industrisë së turizmit. Ky punim thekson mungesën e kualifikimeve dhe specializimeve, duke evidentuar sa e rëndësishme është të përmirësohet cilësia e shërbimeve turistike përmes ngritjes së nivelit të kualifikimit të punonjësve.
- Monitorimi dhe Raportimi i Performancës: Qeveria duhet të vendosë mekanizma të rregullt për monitorimin dhe vlerësimin e impaktit të strategjive të turizmit. Raportimi i të dhënave dhe performancës së sektorit do të ndihmonte në transparencë dhe në identifikimin e ndryshimeve të nevojshme për të përmirësuar qasjen ndaj turizmit.
- Përfshirja e Komuniteteve Vendase: Është thelbësore të angazhohen dhe të përfshihen komunitetet vendase në proceset e vendimmarrjes dhe zhvillimit të turizmit. Kjo do të

ndihmojë në mbrojtjen e kulturës dhe trashëgimisë së vendit, si dhe në ndarjen e përfitimeve ekonomike me komunitetet.

- Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit: Kompanitë turistike duhet të përdorin teknologjitë e informacionit për promovimin dhe menaxhimin e destinacioneve turistike. Kjo do të ndihmojë në arritjen e një audiencë më të gjerë dhe në ofrimin e informacionit të rëndësishëm për turistët.
- Ndërgjegjësim dhe Edukim: Është e rëndësishme të ndërgjegjësohen turistët dhe komunitetet për praktikatat e qëndrueshme turistike, si dhe për rëndësinë e respektimit të mjedisit dhe kulturës së vendit.



## Bibliografia

- Ligji nr. 93/2015 "Për Turizmin", të ndryshuar
- Ligji nr. 55/2015, "Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
- Urdhri nr. 267, datë 24.07.2019 "Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese"
- VKM nr. 413, datë 19.6.2019 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019–2023 dhe të planit të veprimit"
- Programi Qeverisjes 2021-2025
- Të dhëna Statistike nga Instituti i Statistikave (INSTAT)  
<https://www.instat.gov.al/media/11207/tab-1.xlsx>  
<https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/turizmi/publikimet/2023/strukturat-akomoduese-qershor-2023/>  
<https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/turizmi/publikimet/2023/strukturat-akomoduese-qershor-2023/>
- Economic Impact Research by World Travel & Tourism Council  
<https://wttc.org/research/economic-impact>
- Key Tourism Statistics by World Tourism Organization (UNWTO)  
<https://www.unwto.org/tourism-statistics/key-tourism-statistics>
- Glossary of Sustainable Tourism Terms by Global Sustainable Tourism Council (GSTC) <https://www.gstccouncil.org/gstc-criteria/glossary/>
- Raha Shahidsaless, Fernando Blanco, Stefka Slavova, Laureta Qorlazja "Tourism 2.0 in Albania: A new opportunity for resilient growth" World Bank Blogs  
<https://blogs.worldbank.org/europeandcentralasia/tourism-20-albania-new-opportunity-resilient-growth>
- Enrico Porfido "Tourism Development in the Western Balkans: Towards a Common Policy"  
<https://www.co-plan.org/wp-content/uploads/2020/12/Tourism-Development-in-the-western-Balkans-Towards-a-Common-Policy.pdf>
- Ivica P., Malden K., Tina S 'Overtourism'? *Understanding and Managing Urban Tourism Growth beyond Perceptions Volume 2: Case Studies*, pg. 40

[https://www.researchgate.net/publication/331582932\\_'Case\\_study\\_3\\_Barcelona\\_Spain'](https://www.researchgate.net/publication/331582932_'Case_study_3_Barcelona_Spain')

- Albert A., Claudio M., 'Overtourism'? Understanding and Managing Urban Tourism Growth beyond Perceptions Volume 2: Case Studies, pg. 21

[https://www.researchgate.net/publication/331582932\\_'Case\\_study\\_3\\_Barcelona\\_Spain'](https://www.researchgate.net/publication/331582932_'Case_study_3_Barcelona_Spain')

- Niccolò Comerio and Fernanda Strozzi "Tourism and its economic impact: A literature review using bibliometric tools" Tourism Economics Volume 25, Issue 1, February 2019,

<https://journals.sagepub.com/doi/epub/10.1177/1354816618793762>

- Tourism Data and Matching Priorities - Albania, UNWTO,  
<https://www.unwto.org/europe/albania>

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit  
<https://turizmi.gov.al/flukset-e-larta-turistike-konfirmohen-edhe-nga-shifrat-zyrtare-1-7-milione-hyrje-vetem-per-muajin-korrik/>

- <https://www.monitor.al/turistet-humbin-neper-shqiperi-pse-eshte-kaq-e-veshtire-te-behen-plformat-e-hartave-te-transportit-publik/>

- <https://euronews.al/kishin-humbur-ne-gjirin-e-grames-shpetohen-dy-turistet-gjermane-incidenti-me-qenin/>

- <https://euronews.al/humb-jeten-turisti-serb-ne-valbone/>



#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA  
QYTETARE



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)